



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1455/1 prot

Datë 09.06.2025

**FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË
OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI
SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË**

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-43092-04-01-2025, me objekt: “*BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB.*” me fond limit 36,651,600 (*tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë*) lekë pa TVSH dhe 369,509 (*treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntë*) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Laurenc Feracaku*” Person Fizik, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “MUCA” SHPK me NIPT K01421002H, dhe me adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, km.13, Fshati Picar, Vorë Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “*Laurenc Feracaku*” Person Fizik me NIPT: K74304403K, dhe me adresë: *Lagjja “Karbunare e Poshtme”*

Rruga “Rrotondo e Savres”, Ndërtesë me numër pasurie 652/29, zk.2087, Lushnje, Fier.

Në datën 05.06.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 1455/2025, datë 05.06.2025 dhe numër elektronik A/2025/5386, datë 05.06.2025, e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43092-04-01-2025, me objekt: “BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB.” me fond limit 36,651,600 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë) lekë pa TVSH dhe 369,509 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik “MUCA” SHPK, kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Lorenc Feracaku” PF, në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon:

- a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;*
- b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;*
- c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 1455/2025 protokolli, datë 05.06.2025:

Arsyet e skualifikimit:

“Nuk permbush piken 2.3.4 te Kriteve te Vecanta te Kulifikimit per arsyen si meposhte :

- Per artikullin 1 “Tavoline plastike” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.3 ka paraqitur ne SPE Katalog ne te cilin deklaroi qe ky artikull eshte prodhuar nga prodhuesi “IPAE-PROGARDEN” S.p.a Itali, ndersa gjate verifikimit ne mostres se paraqitur nga OE nuk*

evidentohet dhe nuk konstatohet emertim ose logo qe te vertetoje se kjo moster eshte e prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur ne katalog.

- Per artikullin 2 “Stola plastike” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.3 ka paraqitur ne SPE Katalog ne te cilin deklarone qe ky artikull eshte prodhuar nga prodhuesi “Starplastik” Turqi, ndersa gjate verifikimit ne mostres se paraqitura nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emertim ose logo qe te vertetoje se kjo moster eshte prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur ne katalog.

- Per artikullin 3 “Pandofla verore (burrash/grash)” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.3 ka paraqitur ne SPE Katalog ne te cilin deklarone qe ky artikull eshte prodhuar nga prodhuesi “Kajma” Shqiperi, ndersa gjate verifikimit te 2 mostrave te paraqitura nga OE, KVO konstatoji qe pandoflat ngjyre e zeze kane te stampuar pas tyre “Made in China” pra jane prodhuar ne Kine ndersa ne pandoflat ngjyre blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emertim ose logo qe te vertetoje se kjo moster eshte prodhuar kompania prodhuese e paraqitur ne katalog

- Per artikullin 4 “Cizme te gjata pune” operatori ekonomik ne permbushje te kriterit 2.3.3 ka paraqitur ne SPE Katalog ne te cilin deklarone qe ky artikull eshte prodhuar nga prodhuesi “Greateagle Safetz Products” Kine dhe ka bashkengjitur ne kete katalog 2 pale cizme me logon “GGH” dhe “RTRMAX” te cilat i ka paraqitur dhe si mostra. KVO gjate verifikimit te kodeve SS031 dhe SS030 ne faqen web te kompanise prodhuese “Greateagle Safetz Products” Kine <https://www.greateaglesafety.com/> te deklaruar nga OE ne katalog, konstatoji qe cizmet te cilat i perkasin ketyre kodeve nuk permbajne logot e deklaruar dhe paraqitura “GGH” dhe “RTRMAX”. Gjate verifikimeve te metejshme per mostrat e paraqitura evidentohet qe kompania prodhuese e cizmeve me logon “RTRMAX” eshte kompania turke “RTRMAX” me seli ne turqi, ndersa per cizmet me logon “GGH” nuk rezulton qe te prodhohen nga kompania prodhuese “Greateagle Safetz Products” sipas dhe konstatimeve te mesiperme.”.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “MUCA” SHPK, në ankesën me nr. 1455/2025 prot, datë 05.06.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Lorenc Fracaku” PF, si më poshtë:

“Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

2.3. Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.*
- leje drejtimi, e vlefshme;*

2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim - shkarkim gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;*

- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi.

-Mungesa e mostrës, është kusht për skualifikim.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transport mallrash	1 copë	Pronësi/ qera/huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/huapërdorjes.

Shenim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.06.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri